



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



---

**EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 29.3.2012,  
e cila filloi në orën 11:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Hetem Kupina, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Avdush Dobratiqi, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Fetah Salihu, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Shefki Uka, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Valon Hiseni, Shemsi Veseli, Liridon Restelica, Skënder Reçica, Besa Halimi – Zagragja, Lumnie Rama, Shefqet Sylejmani, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Feti Mejdiu, Kimet Zeqa, Sadri Ramabaja dhe Engin Beyoglu.

**Munguan:** Meliza Haradinaj, Musli Mehaj, Afërdita Veliu dhe Astrit Hasani (me leje).

**Morën pjesë edhe** drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE – së, të mjeteve të informimit dhe përfaqësuesi i Policisë së Kosovës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit.

**U konstatua se njëzëri u aprovua ky**

**R E N D I T E:**

1. Informata e Policisë së Kosovës lidhur me gjendjen e sigurisë në komunën e Prishtinës;
2. Propozimvendimi për llogaritjen dhe kompensimin për vlerësimin, mbikëqyrjen, pranimin teknik dhe kolodimin e investimeve komunale dhe investimeve tjera në Komunën e Prishtinës;
3. Propozimvendimi për caktimin e kriterëve bazë për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirave banesore-afariste;
4. Propozimvendimi për inkuorporimin e projekteve të infrastrukturës rrugore në planet rregulluese;
5. Propozimvendimi për shfuqizimin e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme;
6. Raportet vjetore të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale:
  - a. "Trafiku Urban",
  - b. "Ndërmarrja Publike Banesore" dhe
  - c. "Sport-Marketing";
7. Pyetje dhe përgjigje;
8. Të ndryshme.

Para se të fillonin me shqyrtimin e pikëve të rendit të ditës, **Kryesuesi** i njoftoi të pranishmit se, për shkak të pamundësisë teknike, mungon ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

### **Pika e parë**

**Lidhur me gjendjen e sigurisë në komunën e Prishtinës**, informoi **Afrim Ahmeti** përfaqësuesi i Policisë së Kosovës, duke shtuar se Drejtoria Rajonale e Prishtinës vlerëson se situata e sigurisë në komunën e Prishtinës është relativisht e qetë dhe stabile. Nga janari e deri më sot nuk kemi pasur ndonjë incident që ka rrezikuar situatën e sigurisë, edhe pse ka pasur raste, si protesta dhe ngjarje të tjera, të cilat janë menaxhuar me mjaft sukses, pa ndonjë incident të theksuar. Gjithashtu edhe incidente ndëretnike nuk kemi pasur të raportuara.

Shqetësim yni vazhdon të mbeten veprat penale kundër pasurisë, duke i përfshirë grabitjet, vjedhjet, vjedhjet e rënda dhe veprat tjera, si dhe problemet me tollovi në trafik etj.

Drejtoria Rajonale e Prishtinës zotohet se, në bashkëpunim me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare, do të angazhohet në luftimin e dukurive negative dhe ofrimin e rendit dhe sigurisë për të gjithë qytetarët e saj.

**Skënder Reçica** paraqiti një shqetësim në emër të banorëve të lagjes “Arbëria”, njëherësh për të gjithë ata qytetarë që i shfrytëzojnë shkallët e kësaj lagje për qarkullim, duke cekur se kohëve të fundit, veçanërisht në mbrëmje, shkallët e kësaj lagjeje janë shndërruar në një vend gjahu për një grup të caktuar të të rinjve, por jo vetëm të të rinjve, por edhe të moshës pak më të pjekur. Kërkoj që deri në sanimin e gjendjes, të caktohet një patrullë e policisë, apo një shërbim nga ana e Policisë së Kosovës, në mënyrë që t’i identifikojë ata të rinj, apo ata të moshës së pjekur, t’i ndalojë dhe të evitohet kjo dukuri.

**Shefki Gashi** ngriti një shqetësim rreth gjuajtjes me armë nga ana e qytetarëve, vend e pa vend. Kërkoj nga Policia e Kosovës që të merren masa për parandalimin e kësaj dukurie.

**Sadri Ramabaja** ngriti shqetësim, duke shtuar se në lagjen “Kodra e Trimave”, por edhe në lagjet tjera, pas orës 24:00, pothuajse nuk është i sigurt askush, dhe kjo fletë shumë për sigurinë në Prishtinë, ku brenda një jave janë të regjistruara më se 40 vjedhje të shtëpive. Si vlerësohet nga policia kjo gjendje?

**Shefqet Sylejmani** tha se duke pasur parasysh angazhimin e bërë kohëve të fundit në lagjen “Kodra e diellit”, gjithashtu duke patrulluar edhe një pjesë e policëve në rroba civile, e kemi një situatë pak më stabile. Besoj se ndryshimi dhe ndërrimi shumë i shpeshtë i kuadrove që po ndodh nëpër stacionet e policisë, do të ishte mirë që, në aspektin kadrovik, njerëzit të jenë më të qëndrueshëm nëpër stacionet e policisë, e jo të ndërrohen shumë shpesh, sepse atëherë edhe po ndryshon shumëçka.

**Mejreme Berisha** kërkoi nga Policia e Kosovës që të jenë sa më pranë shkollave në parandalimin e veprimeve dhe dukurive negative. Nuk di se a kemi nevojë për sigurime private, kur e kemi sigurimin nga Policia e Kosovës nuk besoj se do të kishim nevojë për sigurim privat..

*Lidhur me shqetësimet, pyetjet dhe sugjerimet e ngritura rreth çështjes së sigurisë së qytetarëve, përfaqësuesi i Policisë së Kosovës dha sqarime të nevojshme.*

## **Pika e dytë**

**Lidhur me Propozimvendimin për llogaritjen dhe kompensimin për vlerësimin, mbikëqyrjen, pranimin teknik dhe kolodimin e investimeve komunale dhe investimeve të tjera në komunën e Prishtinës,** informoi Behxhet Musliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

**Bekim Gashi** në emër të GP të LDK-së tha sa në parim e mbështesim dhe e përkrahim për miratim këtë propozimvendim, por kërkojmë që të dërgohet në Komisionin ndërministror për t'u parë se a është konform ligjeve, për t'u hequr dilemat e mundshme.

**Aziz Pacoli,** në emër të GP të AKR-së, tha se kam një dilemë rreth kompensimit të disa punëtorëve që kanë pranuar mjete në xhirollogaritë e tyre private gjatë pranimin teknik të objekteve private. Është ngritur shqetësimi se mos ka keqpërdorim të mjeteve nga persona të tillë, pra punëtorët që punojnë në Komunë dhe kanë qenë anëtarë të atij komisioni. Kërkoj sqarim se ka pasur apo jo keqpërdorim në këto raste.

**Shemsi Veseli,** në emër të GP të PDK-së, fillimisht ngriti shqetësim për zhvillimin e procedurave rreth këtij materiali, duke thënë se procedurat nuk janë zhvilluar si duhet, pasi që paraprakisht është dashur që këto materiale të kalojnë edhe përmes Komitetit për planifikim dhe ndërtim.

Kjo formë e veprimit do të krijojë hapësirë të njerëzve që janë të prirë për të manipuluar, për t'u korrumpuar, për të dhënë mendime jo të sakta, jo profesionale, që të japin mendime për pranime teknike kur të bëhen dhe mos ta mbajë atë përgjegjësi. Raste të tilla të pranimeve teknike kemi pasur, siç kanë qenë shkollat fillore "Hasan Prishtina", dhe ajo në fshatin Hajvali, pra jemi dëshmitarë edhe për shumë veprime të tjera, që bëhen pranime teknike, për rrugët etj. dhe askush nuk jep përgjegjësi.

Duke u nisur nga ky fakt, që fare nuk janë respektuar këto procedura, GP i PDK-së nuk do ta votojë për miratim këtë propozimvendim.

**Shefqet Sylejmani,** në emër të GP të AAK-së, tha se nuk kemi paragjykime lidhur me këtë propozimvendim, mirëpo është konkludim i përbashkët edhe i KPF-së, që si i tillë të shkojë në nivelin qendror, gjegjësisht në ministri. Në frymën e kësaj e votojmë këtë propozimvendim.

**Shefki Gashi,** në emër të GP të LDD-së, tha se të dhënat lidhur me çmimet që janë pasqyruar në tabelë për pranimet teknike, konsideroj se janë shumë të larta.

Çështje tjetër është se këto pranimet teknike, këto përcjellje të punimeve, nëse bëhen, janë prej kompanive të cilat e fitojnë me tender, apo bëhen nga dikush tjetër dhe a janë edhe punëtorët e Komunës të angazhuar në përcjelljen e këtyre punimeve?

**Feti Mejdriu,** në emër të GP të Partisë së drejtësisë, në parim përkrahu këtë propozimvendim, duke thënë se përkrahja jonë nuk i shkarkon nga përgjegjësia ata, në qoftë se kanë ndodhur disa gjëra gjatë pranimeve teknike që i kemi pa.

**Skënder Reçica** shprehu dilemë lidhur me kuptimin e fjalës *kolodim*, me ç' rast kërkoj të dijë se çfarë kuptimi ka kjo fjalë. Do të ishte mirë që të përdoret fjala shqipe, nëse ekziston.

Rreth çështjes së kompensimit për angazhimin e ekspertëve të jashtëm dhe të brendshëm, tha se do të ishte mirë të na jepej një sqarim pak më i gjerë rreth kësaj.

Për hir të korrektësisë dhe transparencës, është dashtë që në të gjitha tabelat, krahas vlerave të kontratës, të jepen edhe emërtimet e projekteve.

*Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, Behxhet Musliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dha sqarime të nevojshme.*

**Me shumicë votash, pesë kundër (Shemsi Veseli, Skënder Reçica, Liridon Restelica, Lumnie Rama dhe Sadri Ramabaja), u miratua Vendimi për llogaritjen dhe kompensimin për vlerësimin, mbikëqyrjen, pranimin teknik dhe kolodimin e investimeve komunale dhe investimeve tjera në komunën e Prishtinës.**

#### **Pika e tretë**

**Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e kritereve bazë për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirave banesore - afariste, informoi Behxhet Musliu.**

**Mustafë Krasniqi**, në emër të GP të LDK-së, tha se e përkrahim dhe e votojmë këtë propozimvendim për miratim.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, kërkoi respektimin e kritereve që parasheh ky propozimvendim.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, tha se e kemi analizuar këtë propozimvendim dhe kemi konstatuar se ka qenë i krijuar një dualizëm. Është gabimi më i madh i Zyrës ligjore dhe Njesisë së auditimit të brendshëm, sepse sikur ato të vepronin si duhet, nuk do të lejohej të bëhen gabime të këtilla. Në këtë aspekt, falënderoi drejtorin për koshiençë dhe, në anën tjetër, që na ka nxjerrë nga një situatë jo e mirë.

**Mejreme Berisha**, në emër të GP të AAK-së, tha se e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

**Shefki Gashi**, në emër të GP të LDD-së, tha se e përkrahim këtë propozimvendim, me një sugjerim që, kur të jetë nevoja, të bëhen këto ndërrime të destinimeve, por gjithnjë duke i ruajtur kushtet teknike.

**Feti Mejdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, e përkrahu këtë propozimvendim për miratim.

**Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e kritereve bazë për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirave banesore - afariste;**

#### **Pika e katërt**

**Lidhur me Propozimvendimin për inkorporimin e projekteve të infrastrukturës rrugore në planet rregulluese, informoi Behxhet Musliu.**

**Mustafë Krasniqi**, në emër të GP të LDK-së, tha se e përkrahim këtë propozimvendim për miratim dhe urojmë që këto projekte të realizohen sa më shpejt.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, kërkoi që, përveç projekteve të infrastrukturës rrugore, të jetë edhe infrastruktura nëntokësore e planeve rregulluese dhe e rrugëve në përgjithësi.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe në këtë propozimvendim është bërë shkelje procedurale, pra nuk është debatuar në Komitetin për planifikim. Së pari është dashur që në bazë të projekteve të bëhen planet rregulluese. Përgjegjësi mbajnë Drejtoria e Infrastrukturës Lokale dhe Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit që e ka lejuar, ose nuk e ka ofruar infrastrukturën rrugore me kohë, nuk i ka bërë analizat e duhura çfarë ishte dashur, dhe të vijmë në një situatë kur tash duhet t'i miratojmë.

Me këtë propozimvendim po tangojnë shumë plane rregulluese, andaj dhe në këtë aspekt poanta e krejt këtyre që po ndodhin, është se Komunës së Prishtinës po i mungon plani zhvillimor urban dhe plani zhvillimor komunal. Duke i pasur për bazë të gjitha këto, si

mungesa e incizimeve gjeodezike, numri i parcelave kadastrale, gjegjësisht në të cilat po bëhet ndryshimi, me këtë formë se si është sjellë ky propozimvendim nuk e votojmë për miratim.

**Mejreme Berisha**, në emër të GP të AAK-së, tha se këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

**Shefki Gashi**, në emër të GP të LDD-së, shprehu mendimin se me rastin e atakimeve të pronave të ndryshme, do të duhej të parashiheshin edhe ato veprime anësore, duke i pasur për bazë planet e atëhershme dhe ndryshimet që ka pësuar qyteti i Prishtinës.

**Feti Mejdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, e përkrahu miratimin e këtij propozimvendimi.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, u shpreh se ky propozimvendim na vjen me një qasje krejtësisht tjetër nga ajo që e kishim vitin e kaluar për të njëjtat probleme. Është e vetëkuptueshme arsyeja pse, sepse në lagje të tëra të Prishtinës, planet rregulluese nuk respektohen nga ndërtuesit, nga Komuna etj. Në këtë formë po legjitimohet kaosi urban dhe po bëhet shpërndarja e përgjegjësisë legale, politike dhe morale, andaj distancohem nga kjo formë e punës dhe nuk do të votoj.

**Liridon Restelica** u ndërlidh kryesisht rreth projektit të unazës "Qendër", duke shtuar se, sipas planit parashihet që të bëhet lëvizja e binarëve të hekurudhës. Kërkoj të dijë se a parashihet që të rregullohet një pjesë gjelbëruese në atë hapësirë dhe cila do të jetë hapësira e përshtatshme e Stacionit të ri hekurudhor. Sipas informacionit që kemi, hekurudha ka bërë që dy vite kërkesë për ndërtimin e stacionit të ri hekurudhor.

*Lidhur me vërejtjet e dhëna, Behxhet Musliu dha sqarime të nevojshme.*

**Me shumicë votash, katër kundër (Aziz Pacolli, Skënder Reçica, Shemi Veseli dhe Sadri Ramabaja), u miratua Vendimi për inkuorporimin e projekteve të infrastrukturës rrugore në planet rregulluese.**

### **Pika e pestë**

**Për Propozimvendimin për shfuqizimin e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme, informoi Behxhet Musliu.**

**Mustafë Krasniqi**, në emër të GP të LDK-së, e përkrahu këtë propozimvendim për shfuqizimin e Vendimit, por shprehu mendimin se do të ishte mirë që kjo rregullore të rishqyrtohet edhe njëherë në tërësi.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, tha se është tejet shqetësuese fakti se një pjesë e trotuareve para lokaleve, janë të uzurpuara prej karrigeve dhe tavolinave. Sugjeroi që për vendosjen e tyre, të jepet pëlqim urbanistik dhe leje nga drejtoria përkatëse, pra të jetë një projekt i njëjtë për të gjithë. Me përpunimin e rregullores, ndoshta do ta rregullonim këtë çështje.

**Shemi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, u shpreh se realisht ka qenë dualizëm i krijuar, është ndërhyrë në kompetencat çfarë i ka Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit, gjegjësisht është shkelur Ligji për ndërtim.

Do ta votojmë këtë propozimvendim, për arsye që të kthehen në normalitet në aspektin procedural.

**Mejreme Berisha**, në emër të GP të AAK-së, e përkrahu për miratim këtë propozimvendim.

**Feti Mejdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, e përkrahu miratimin e këtij propozimvendimi.

**Besa Rafuna** në emër të GP të LDD-së, tha se edhe pse ky propozimvendim po bie në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit për ndërtim, është në të mirën e harmonizimit të ligjit dhe të rregullores, atëherë edhe ne e përkrahim për miratim.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se tha se para disa muajve ky propozimvendim na është sjellë këtu, me arsytim jashtëzakonisht të mirë, dhe është votuar. Një pjesë prej nesh kemi votuar kundër, dhe na vjen mirë që sot sillet prapë këtu në Kuvend falë vërejtjeve që kanë marrë për shkeljen e ligjit, por mbi të gjitha për shkak të presionit që ka shkaktuar në opinion.

*Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e paraqitura, sqarime plotësuese paraqiti **Behxhet Musliu**.*

**Njëzëri u miratua Vendimi për shfuqizimin e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme.**

**Pika e gjashtë**

**Raportet vjetore të komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale:**

- a) "Trafiku Urban"
- b) "Ndërmarrja Publike Banesore" dhe
- c) "Sport-Marketing"

**Hazir Borovci**, në emër të GP të LDK-së dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të aksionarëve në NPK "Trafiku Urban", tha se viti 2011 ishte vit sfidues për shumë rrethana, siç janë grevat, problemet e grumbulluara më herët, numri i pamjaftueshëm i autobusëve, operatorët ilegal, lëvizjet e drejtorëve etj. Por, si do që të jetë, Komisioni i aksionarëve në NPK "Trafiku Urban", raportit ia ka bashkëngjitur edhe të dhënat e përgjithshme të kompanisë. Edhe përkundër vështirësive dhe sfidave, nuk ka munguar një bashkëpunim, një koordinim i punëve në mes të Komisionit të aksionarëve, drejtorit, gje gjësisht kryeshefit ekzekutiv të ndërmarrjes, dhe organeve tjera të Komunës. Komuna ka angazhuar edhe një ekip të ekspertëve të USAID-it, për të përgatitur një projekt të fizibilitetit për procedimin e mëtejme të kësaj kompanie.

Në emër të GP të LDK-së e përkrahu miratimin e raportit, duke i pasur parasysh edhe vërejtjet që do t'i kenë të tjerët.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, tha se NPL "Trafiku Urban" është në gjendje që nuk ka qenë asnjëherë më parë. Kur kemi të bëjmë me këtë ndërmarrje, një gjë është shumë brengosëse, pasi që më parë janë marrë disa vendime për disa linja të reja, të cilat ende nuk janë lëshuar në përdorim. Është një kaos total në trafik nga taksistët e vegjël, kombit dhe autobusë privat që veprojnë ilegalisht. Për të dalë nga kjo situatë, do të ishte mirë që të jetë një partner publiko- privat, andaj mënyra se çfarë është sot, është e papranueshme të diskutojmë rreth kësaj.

Sa i përket raportit të ndërmarrjes "Sport - Marketing", është një raport më i kompletuar, por mbetet që projektet që janë kërkuar prej saj në vitin e kaluar, të realizohen sivjet.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, shprehu mendimin se anëtarët e komisioneve të aksionarëve të këtyre ndërmarrjeve lokale, në të ardhmen duhet të jenë sa më koshient dhe, në anën tjetër, t'i respektojnë normat ligjore.

Gjendja në trafikun urban është e dhimbshme dhe në bazë të analizave, mendohet që në të ardhmen të jetë një partneritet publiko - privat.

Veprimi i operatorëve ilegalë në vijat e njëjta të Trafikut Urban, e dëmtojnë trafikun në masë të madhe, andaj besoj dhe shpresoj që, pas analizave të fizibilitetit dhe pas gjithë asaj që ky grup është edhe i ndërkombëtarëve, dhe me një vendim dhe përkrahje më të fuqishme të komunës dhe partneriteti publiko - privat, gjendja në këtë ndërmarrje do të normalizohet.

Sa i përket raportit të Ndërmarrjes Publike Banesore, mund të konstatojmë se në këtë raport mungojnë disa të dhëna të auditimit të brendshëm, për të ditur se sa është kontrolli i brendshëm në këtë ndërmarrje.

Lidhur me NPL "Sport - Marketing", mendojmë se edhe kjo ndërmarrje nuk është mbështetur sa duhet nga Komuna.

Janë disa projekte që janë madhore, të cilat duhet të realizohen, dhe që nuk mund t'i përballojë ndërmarrja me këtë buxheti që ka, siç janë disa projekte rreth pishinës, projekti me Shtëpinë e Gurit në Brezovicë, projekte të cilat duhet të financohen nga Komuna.

Këto raporte i përkrahim për miratim.

**Shefqet Sylejmani**, në emër të GP të AAK-së dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të aksionarëve të NPB-së, tha se kjo ndërmarrje është regjistruar në Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë, përkatësisht Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Republikën e Kosovës, si NPB, gjegjësisht SH A në Prishtinë.

Ndërmarrja administrohet nga Komuna e Prishtinës, pronë e së cilës është 100%, përmes Komisionit komunal të aksionarëve.

Ndërmarrja është e organizuar në 4 njësi organizative dhe atë: 1. Sektori administrativ, 2. Sektori teknik, 3. Sektori ekonomik dhe 4. Prokurimi. Gjithashtu, në pajtim me dispozitat e Ligjit për NP, është formuar Komisioni i auditimit të brendshëm dhe është zgjedhur zyrtari i auditimit të brendshëm. Ndërmarrja ka 85 të punësuar, struktura e të cilëve është dhënë në raport.

Në këtë raport janë shënuar vetëm disa nga të dhënat për punën dhe veprimtarinë e sektorëve në veçanti, dhe ndërmarrjes në përgjithësi. Me gjithë sukseset e shumta evidente të pa kontestueshme të këtij mandati, ende vazhdon të përballlet me disa prej problemeve objektive, në veçanti procedurave gjyqësore ndaj uzurpatorëve, atakuesve të tjerë të pronës së ndërmarrjes, dhe papërgjegjësisë qytetare e njerëzore të disa shfrytëzuesve të objekteve dhe shërbimeve të saj.

Me qëllim të transparencës së plotë, në këtë raport janë dhënë tabelat financiare, që paraqesin një bilanc pozitiv të suksesit, ku shihet një afarizëm pozitiv dhe rritje krahasuar me vitin paraprak etj.

Në frymën e kësaj, më duhet të përsëris vlerësimet nga shqyrtimet e raporteve të mëparshme të NPK-së, si dhe atyre të sotme, e që janë:

- a. Komisioni i aksionarëve dhe Bordi i drejtorëve janë në shpërputhje me funksionin (thirrjen që e kanë) dhe përgjegjësinë e tyre;
- b. Edhe në raportin e Komisionit të aksionarëve - Bordi i drejtorëve - shef ekzekutiv, çështjet çalojnë. Ligji aktual këto raporte veç sa i ndërlikon si raporte e përgjegjësi.

Në raste të caktuara, kompetencat e varësit dalin mbi kompetencat e organit më të lartë;

- c. Megjithatë, shumë çka nga këto raporte mund dhe duhet rregulluar me marrëveshje dhe ujdj të përgjithshme dhe
- d. Duhet gjetur zgjidhje adekuate për kompensimin e punës dhe aktivitetit të Komisionit të aksionarëve, në harmoni me përgjegjësinë që e kanë, përderisa Bordi i drejtorëve, i zgjedhur nga ta, kompensohet dhe kështu krijohet një pakuptimsi e llojit të vet, por edhe nga fakti se pa stimulim adekuat, përherë do të mungojë angazhimi i nevojshëm i aksionarëve.

Sa i përket Trafikut Urban, janë disa çështje që ne i shohim si problematike, dhe mendoj që do të ishte pjesë e pjesëmarrjes tonë në diskutim rreth këtyre çështjeve :

1. Është më se e nevojshëm përfundimisht të gjendet një zgjidhje për Trafikun Urban. Konsolidimi i menjëhershëm i radhëve të punëtorëve, ngritja e nivelit të përgjegjësisë dhe disiplinës, pastërtisë së autobusëve, rendit dhe rregullit, përmbajtja strikte e itinerarit dhe rregullsia në mbajtjen e linjave përkatëse të Trafikut Urban;
2. Menaxhmenti i Trafikut Urban duhet të reagojë më shpejt në kërkesat e qytetarëve për disa linja të reja, që do të ishin të domosdoshme dhe më se të nevojshme për qytetarët.
3. Qëndrimi i GP të AAK-së, ka qenë më herët dhe mbetet si qëndrim alternativ, ndoshta për momentin i vetëm, partneriteti publiko - privat për NP "Trafiku Urban".

Sa i përket NPL "Sport - Marketing", gjithashtu iu bashkëngjitemi diskutuesve të mëhershëm. Komuna ka obligim që t'i ndihmojë shumë në këtë drejtim Sport - Marketingut, edhe me Shtëpinë e Gurit në Brezovicë, por edhe me Pishinën e Gërmisë. Këto objekte tash për tash janë nga të cilat, në një mënyrë apo në tjetrën, prej të cilave priten fitime për ekzistencë të këtij institucioni, gjegjësisht këtij asociacioni.

Këto raporte i përkrahim për miratim.

**Besa Rafuna**, në emër të GP të LDD-së, në veçanti u ndërlidh me raportin e ndërmarrjes "Trafiku Urban", duke cekur se janë shumë probleme evidenete, por duhet të bëhet një zgjidhje adekuate.

Derisa të bëhet një zgjidhje tjetër, Komuna do duhej të ishte më efikase në parandalimin e operatorëve ilegalë, të cilët e kanë dëmtuar dhe e dëmtojnë çdo ditë këtë ndërmarrje.

**Kimet Zeqa**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, kryesisht u ndërlidh me raportin e ndërmarrjes lokale "Trafiku Urban", ku kemi një kolaps total dhe është për çdo kritikë, pasi që nuk ka kurrfarë orari në stacione dhe këtë çdo herë e kam kërkuar.

Komuna gjithsesi duhet ta bëjë një zgjidhje për ndalimin e operatorëve ilegalë.

Sa i përket raportit të Ndërmarrjes Publike Banesore, ngriti shqetësim rreth disa mirëmbajtjeve që i bën kjo ndërmarrje, siç është pastrimi i oxhaqeve etj.

Sa i përket ndërmarrjes "Sport - Marketing", pajtohem me ato projekte të cilat janë në program për realizim.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se ndërmarrjes publike "Trafikut Urban", para një viti, i premtuam një mbështetje relativisht të mirë financiare dhe në forma tjera, dhe pas një viti gjendja është edhe më kaotike se që ishte para një viti. Trafiku Urban është sinonim i keqmenaxhimit të NP-ve, tash më kjo është e qartë publikisht. Si zgjidhje propozohen metodat e ndërmarrjeve



publiko-private, të cilat praktikisht edhe atje ku janë aplikuar, janë treguar të dështuara. Komiteti për urbanizëm i LV – së e ka përpunuar një projekt, një propozimin konkret se si do të duhej të bëhej zgjidhja, sipas modeleve të qyteteve të mëdha, sidomos të Amerikës Qendrore, Bolivisë, para së gjithash që kanë pasur jashtëzakonisht problem me trafikun edhe për arsye tjera, sepse, janë ngritur qytetet mbi kaosin urban.

Po shihet se stihia i ka gërryer këto ndërmarrje përgjithësisht , sidomos Trafikun Urban, dhe për këtë Komuna ka përgjegjësi për këtë gjendje.

Sa i përket raportit të NPB, thuajse gjendja është e njëjtë me at të Trafikut Urban.

Te ndërmarrja “Sport-Marketingu”, vitin e kaluar kemi mbështetur një projekt për Shtëpinë e Gurit në Brezovicë. E mbështes këtë ide, sepse është pasuri publike dhe do ti shfrytëzonin qytetarët, të gjitha ato pika të rëndësishme të pushimit dhe të rekreacionit.

Lidhur me këto projekte tha se kam pasur takime private me një mik nga Zvicra, që do ta vizitojë komunën tonë nesër, dhe ju kisha bërë thirrje që dy projektet e ndërmarrjes “Sport - Marketing” t’ia prezantoni, sepse në bisedë private që kam pasur unë, ai ka shprehë njëfarë gatishmërie për pjesëmarrje, ose për mbështetje.

**Hetem Kupina** ngriti shqetësim, duke thënë se ndërmarrja “Trafiku Urban” është përfshirë nga një sëmundje e rëndë, pra të ekzistojë, apo të mos ekzistojë!

Duke i pasur parasysh obligimet e Komunës që i ka ndaj kësaj NPK-je, pyes kompetentët komunalë, gjegjësisht Drejtorinë e Shërbimeve Publike, dhe për këtë kërkoi përgjigje me shkrim: *Cili është vizioni juaj, që kjo ndërmarrje të vendoset në binar të mbijetesës?*

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerime e dhëna për raportet e të tri ndërmarrjeve publike lokale, kryesuesi dha sqarime të nevojshme.

**Me shumicë votash, një kundër (Sadri Ramabaja), u miratuan raportet e komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale: “Trafiku Urban”, “ Ndërmarrja Publike Banesore” dhe “Sport-Marketing”.**

**Pika e shtatë dhe e tetë  
Pyetje dhe përgjigje**

**Mejreme Berisha** parashtrori këtë kërkesë:

Rruga “Dëshmorët e Marecit”, kthinat apo rrugicat që duhet të dalin në rrugën “Isa Kastrati” janë aq të ngushta, sa që nuk ka ditë që nuk bëhet ndonjë ndeshje në udhëtimet në dy drejtime. Kërkoi nga organet kompetente që ato rrugica t’i bëjnë njëkahore.

**Hetem Kupina, kërkesë për Drejtorinë e Financave dhe Pronës**

Kërkoi nga ky organ që të dalë në terren, konkretisht në Bardhosh, që rreth objektit të Komunës të bëjë identifikimin e pronës së uzurpuar dhe lirim të saj, si dhe të bëjë identifikimin e pronës së uzurpuar dhe lirim të saj edhe te Stadiumi në qendër të fshatit Bardhosh.

**Naim Makolli, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale**

Rrugët “Tutini” dhe “Aziz Zhilivoda”, kanë përfunduar në një farë forme, mirëpo në një mbledhje më herët kam pyetur dhe më është thënë se do të pranohet teknikisht diku në dhjetor. Dhjetori ka kaluar dhe nuk e di se a janë pranuar teknikisht. Nëse janë pranuar, shtroj pyetjen se pse në pjesën e atyre rrugëve që janë të ndërtuara me katrorë nuk është bërë shkelja e tyre fare dhe sot e kësaj dite është në atë gjendje? Kur do të përfundojnë punët në këto dy rrugë?

## **Pyetje për Kryesuesin e Kuvendit**

Kohëve të fundit shohim që me decentralizimin ose me ndarjen e disa komunave, ku një pjesë e territorit kadastral të komunës së Prishtinës ka kaluar në Graçanicë, ne shohim atje se në atë komunë kemi ndërtime masive private, shiten parcela masive dhe ndërtohet, d.m.th qytetarët e Prishtinës detyrohen sot të ndërtojnë në komunën e Graçanicës për shkak të disa lehtësirave që i kanë atje.

Unë shtroj një pyetje dhe një kërkesë. Komuna e Prishtinës a ka mundësi dhe a ka në plan të ndajë parcela, normalisht që do të shiten për qytetarët e vet që kanë mundësi të ndërtojnë ndërtime të ulëta private.

Kërkoj nga Komitetit për Politikë dhe Financa që të merret një iniciativë e tillë, që në komunën e Prishtinës të ketë mundësi të ndahen parcela, ku qytetarët kanë mundësi të blejnë parcela dhe të ndërtojnë në vet komunën ku jetojnë.

*Lidhur me shqetësimin e ngritur rreth ndërtimeve në komunën e Graçanicës, si dhe rreth kërkesës për marrjen e një iniciative që në komunën e Prishtinës të ketë mundësi të ndahen parcela për ndërtim për qytetarët e Prishtinës, **Kryesuesi** dha sqarime të nevojshme.*

**Ridvan Shahini**, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, për pyetjen e parashtruar nga z. Makolli, rreth përfundimit të punimeve në rrugët "Tutini" dhe "Aziz Zhilivoda", tha se këto rrugë ende nuk janë të pranuar teknikisht, por pritet që brenda muajit prill të përfundojnë dhe të bëhet pranimi teknik.

## **Naime Osmani, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale dhe për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.**

Më parë kam bërë 2-3 pyetje, gjithnjë duke cekur çështjen e kanalizimit në fshatin Besi, dhe nuk më është kthyer përgjigje, dhe pak më parë pata thirrje telefonike nga banorët e fshatit Besi, të cilët kanë probleme me kanalizim.

Gjithashtu në fshatin Rimanishtë po sillen mbeturinat nga fshatrat përreth, ndodh edhe nga qyteti, që po i hedhin afër kanalit "Ibër - Lepenc" dhe në pjesët e gjelbëruara në mes të fshatit Besi dhe Rimanishtë. Lidhur me këtë çështje, me mbikëqyrjen e mbeturinave apo menaxhimin e tyre, unë nuk e di se kush do të japë përgjegjësi.

**Ridvan Shahini**, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, për pyetjen e parashtruar nga znj. Osmani, tha se paraprakisht duhet të zgjidhen çështjet pronësore - juridike dhe kur të zgjidhen këto, kanalizimi nuk do të kalojë nëpër oborre.

**Ajnishahe Azemi** tha se afër gjimnazit "Xhevdet Doda" ka filluar të bëhet depo e mbeturinave. Kërkoj nga organet kompetente që t'i largojnë mbeturinat e grumbulluara, apo të vënë pengesa që të mos i hedhin prapë ato mbeturina.

*Lidhur me shqetësimin e ngritur nga znj. Azemi, **kryesuesi** dha sqarime të nevojshme.*

***Kryesuesi** edhe kësaj radhe kërkoi nga drejtorët e drejtorive që, për pyetjet e parashtruar nga këshilltarët e Kuvendit, përgjigjet të jenë të sakta dhe të kthehen me kohë.*

*Mbledhja mbaroi në orën 14:30.*

**PROCESMBAJTËSI**  
**Zijadin Gashi**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**